

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 6371 prot

Roskovec, më 12.08.2024

### NJOFTIM

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK DHE PARAQITJE TË DOKUMENTAVE LIKUIDUES

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 190, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë neni 162, njoftojmë të gjithë të shpronësuarit me VKM nr. 455, datë 10.07.2024 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3 , në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)", Bashkia Roskovec", të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 119, Datë 12.07.2024, duhet të paraqesin dokumentacionin justifikues për kompensimin, për pasuritë e shpronësuara nr. 2/282, nr. 2/283, nr. 352/13, nr. 352/18 dhe nr. 349/10 zona kadastrale 3196 në Bashkinë Roskovec, në mënyrë që të vijohet procedura përkatëse për kompensim.

**Dokumentacioni që duhet të paraqisni për likuidim pranë Bashkisë Roskovec është:**

1. Kërkesë për shpërblim nga shpronësimi.
2. Kartela e rifreskuar e pasurisë e tre muajve te fundit + HTR.
3. Certifikata e pronësisë e noterizuar.
4. Prokurë e posacme përfaqësimi, kur nuk paraqitet personalisht personi i cili ka emrin në listën e pronarëve të shpronësuar me VKM.
5. Vërtetim nga banka për llogarinë bankare, ku të përcaktohet numri i llogarisë dhe numri i IBAN-it.(Këtë vërtetim e merr nga banka personi i interesuar).
6. Fotokopje e kartës se identitetit.
7. Dëshmi trashëgimie, kur personi që shpronësohet nuk jeton.

Nga ana e Bashkisë Roskovec vetëm pas paraqitjes dhe protokollimit të këtij dokumentacioni pranë institucionit, do të vijohet me procedurën e likuidimit të vlerës së shpronësimit .

**Kërkojmë paraqitjen e dokumentave të sipërcituar, pranë zyrës së Informacionit, në Bashkinë Roskovec ose me postë, në mënyrë që të vijohet me likuidimin e vlerës së shpronësuar.**

Këtij njoftimi i bashkëlidhen:

- VKM nr. 455, datë 10.07.2024 së bashku me listën e plotë të të shpronësuarve
- Shkresat nr. 153/17, datë 16.07.2024 të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim njoftim për shpronësim publik për pasuritë nr. 2/282 dhe nr. 2/283 për të shpronësuarit bashkëpronarët: Eqerem Risilia, Et'hem Resuli, Hajrie Shehu, Ilirjan Kongoli, Jolldiz Bedini, Kujtim Kryeziu, Mehdije Hoxha, Muharrem Resuli, Pranvera Kryeziu, Rubie Risilia, Senije Resuli, Umberto Resuli, Xheladin Kryeziu, Ymid Resuli.
- Shkresa nr. 153/17, datë 16.07.2024 e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim njoftim për shpronësim publik për pasurinë nr. 352/13 për të shpronësuarin Servet Dervish Pirra.
- Shkresa nr. 153/17, datë 16.07.2024 e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim njoftim për shpronësim publik për pasurinë nr. 352/18 për të shpronësuarin Gezim Servet Pirra.
- Shkresa nr. 153/17, datë 16.07.2024 e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim njoftim për shpronësim publik për pasurinë nr. 349/10 për të shpronësuarit bashkëpronarët: Fredi Asqeri Dyle, Zana Elmas Dyle, Rudina Asqeri Mullaj, Resmije Asqeri Rrapushaj, Edlira Asqeri Haxhijaj, Mira Asqeri Xhaxhaj, Xhuljeta Asqeri Dyle

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**K R Y E T A R I**

**Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Delina HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 455 , datë 10.7.2024

P Ë R

SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE  
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN  
NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI URBAN  
I NJË PJESE TË BLOKUT NR.3, NË QENDËR TË QYTETIT  
TË ROSKOVECIT (FAZA 1)", BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)", Bashkia Roskovec.



2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Roskovec.
8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Roskovec për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Roskovec, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.



12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU




NR.PROT.3782/1  
DATE 11.7.2024

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BASHKISË ROSKOVEC  
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS,  
DREJTORIA VENDORE FIER  
AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE  
VLERËSIMIT

Nr. 53/Prot  
17

Tiranë, më 16.7.2024

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

B.P: EQEREM RISILIA, ET' HEM RESULI, HAJRIE SHEHU, ILIRJAN KONGOLI,  
JOLLDIZ BEDINI, KUJTIM KRYEZIU, MEHDIE HOXHA, MUHARREM  
RESULI, PRANVERA KRYEZIU, RUBIE RISILIA, SENIJE RESULI, UMBERTO  
RESULI, XHELADIN KRYEZIU, YMID RESULI ✓

Për dijeni:

BASHKISË ROSKOVEC  
Adresa: Roskovec, Fier

Bashkëlidhur kësaj shkrese po Ju dërgojmë Vendimin Nr. 455, datë 10.07.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)' Bashkia Roskovec, ku jeni shpronësuar për pasurinë me numër 2/282, të llojit "Truall", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3196;

- Sipërfaqja e Truallit që shpronësohet është  $6900 \text{ m}^2 \times 494 \text{ lekë/m}^2 = 3,408,600 \text{ lekë}$ ;

Vlera totale e shpronësimit është = 3,408,600 lekë.

Bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ju vetëm për masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, keni të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

Procedura e dhënies së masës së shpërblimit për këtë shpronësim, do të fillojë pasi të keni paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë për pronën objekt shpronësimi, vërtetimin e bankës lidhur me numërin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit të shoqëruar me një kërkesë pranë Bashkisë Roskovec.

Në mungesë të adresave të pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues Bashkisë Roskovec marrjen e masave për njoftimin e tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE  
VLERËSIMIT

Nr/53/Prot

Tiranë, më 16.7.2024

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

B.P: EQEREM RISILIA, ET' HEM RESULI, HAJRIE SHEHU, ILIRJAN KONGOLI,  
JOLLDIZ BEDINI, KUJTIM KRYEZIU, MEHDIJE HOXHA, MUHARREM  
RESULI, PRANVERA KRYEZIU, RUBIE RISILIA, SENIJE RESULI, UMBERTO  
RESULI, XHELADIN KRYEZIU, YMID RESULI

Për dijeni:

BASHKISË ROSKOVEC  
Adresa: Roskovec, Fier

Bashkëlidhur kësaj shkrese po Ju dërgojmë Vendimin Nr. 455, datë 10.07.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)' Bashkia Roskovec, ku jeni shpronësuar për pasurinë me numër 2/283, të llojit "Truall", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3196;

- Sipërfaqja e Truallit që shpronësohet është  $9775 \text{ m}^2 \times 494 \text{ lekë/m}^2 = 4,828,850 \text{ lekë}$ ;


Vlera totale e shpronësimit është  $= 4,828,850 \text{ lekë}$ .

Bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ju vetëm për masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, keni të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

Procedura e dhënies së masës së shpërblimit për këtë shpronësim, do të fillojë pasi të keni paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësive për pronën objekt shpronësimi, vërtetimin e bankës lidhur me numërin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit të shoqëruar me një kërkesë pranë Bashkisë Roskovec.

Në mungesë të adresave të pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues Bashkisë Roskovec marrjen e masave për njoftimin e tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHITETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE  
VLERËSIMIT

Nr/53/Prot  
117

Tiranë, më 16. 7. 2024

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

PRONARIT: SERVET DERVISH PIRRA ✓

Për dijeni:

BASHKISË ROSKOVEC

Adresa: Roskovec, Fier

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë Vendimin Nr. 455, datë 10.07.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi urban i një pjese te bllokut nr.3,në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)' Bashkia Roskovec, ku jeni shpronësuar për pasurinë me numër 352/13, të llojit "Are", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3196;

- Sipërfaqja e Ares që shpronësohet është  $2675 \text{ m}^2 \times 269 \text{ lekë/m}^2 = 719,575 \text{ lekë}$ ;

Vlera totale e shpronësimit është = 719,575 lekë.

Bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ju vetëm për masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, keni të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

Procedura e dhënies së masës së shpërblimit për këtë shpronësim, do të fillojë pasi të keni paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë për pronën objekt shpronësimi, vërtetimin e bankës lidhur me numërin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit të shoqëruar me një kërkesë pranë Bashkisë Roskovec.

Në mungesë të adresave të pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues Bashkisë Roskovec marrjen e masave për njoftimin e tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE  
VLERËSIMIT

Nr. 53/Prot

Tiranë, më 16. 7. 2024

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

PRONARIT: GEZIM SERVET PIRRA ✓

Për dijeni:

BASHKISË ROSKOVEC  
Adresa: Roskovec, Fier

Bashkëlidhur kësaj shkrese po Ju dërgojmë Vendimin Nr. 455, datë 10.07.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)' Bashkia Roskovec, ku jeni shpronësuar për pasurinë me numër 352/18, të llojit "Ares", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3196;

- Sipërfaqja e Ares që shpronësohet është  $1286 \text{ m}^2 \times 269 \text{ lekë/m}^2 = 345,934 \text{ lekë}$ ;

Vlera totale e shpronësimit është = 345,934 lekë.


Bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ju vetëm për masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, keni të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

Procedura e dhënies së masës së shpërblimit për këtë shpronësim, do të fillojë pasi të keni paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësive për pronën objekt shpronësimi, vërtetimin e bankës lidhur me numërin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit të shoqëruar me një kërkesë pranë Bashkisë Roskovec.

Në nungesë të adresave të pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues Bashkisë Roskovec marrjen e masave për njoftimin e tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI PËR QËLLIMIN





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
DREJTORIA E KONTROLLIT TË DOKUMENTACIONIT DHE  
VLERËSIMIT

Nr. 53/Prot  
117

Tiranë, më 16.7.2024

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

BP: FREDI ASQERI DYLE, ZANA ELMAS DYLE, RUDINA ASQERI MULLAJ,  
RESMIJE ASQERI RRAPUSHAJ, EDLIRA ASQERI HAXHIAJ, MIRA ASQERI  
XHAXHIAJ, XHULJETA ASQERI DYLE

Për dijëni:

BASHKISË ROSKOVEC

Adresa: Roskovec, Fier

Bashkëlidhur kësaj shkrese po Ju dërgojmë Vendimin Nr. 455, datë 10.07.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)" Bashkia Roskovec, ku jeni shpronësuar për pasurinë me numër 349/10, të llojit "Ares", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3196;

- Sipërfaqja e Ares që shpronësohet është  $476m^2 \times 269 \text{ lekë}/m^2 = 128,044 \text{ lekë}$ ;

Vlera totale e shpronësimit është = 128,044 lekë.

Bazuar në nenin 24, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ju vetëm për masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim, keni të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijëni.

Procedura e dhënies së masës së shpërblimit për këtë shpronësim, do të fillojë pasi të keni paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë për pronën objekt shpronësimi, vërtetimin e bankës lidhur me numërin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit të shoqëruar me një kërkesë pranë Bashkisë Roskovec.

Në mungesë të adresave të pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues Bashkisë Roskovec marrjen e masave për njoftimin e tij.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

